



C.nr.847/15

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil**, me gjyqtarin Misin Frangu dhe zyrtaren ligjore Arbelinda Tahiri, në çështjen e inicuar me padinë e paditeses Byroja Kosovare e Sigurimit (BSK) me seli në Prishtinë, kundër të paditurit [REDACTED], nga Ferizaj, Rr. [REDACTED] p.n., për shkak të rimbursimit të dëmit, me datë 09.01.2018, jashtë seancës gjyqësore, marrë këtë:

### A K T G J Y K I M


- për shkak të padëgjueshmërisë / mosbindjes -

**APROVOHET** në tërsi padia dhe kërkesëpadia e paditëses Byroja Kosovare e Sigurimit (BSK) me seli në Prishtinë dhe **OBLIGOHET** i padituri [REDACTED] nga Ferizaj, Rr. [REDACTED] p.n. që në emër të rimbursimit të dëmit t'ia paguajë paditëses shumën prej **430 €**, me kamatën e cila do të llogaritet sipas lartësisë që aplikojnë bankat vendore për deponimet e rëndomta të qytetarëve, për periudhë afatizuese një vjeçare, nga data e nxerrjes së këtij aktgjykimi e deri në pagesën përfundimtare.

### A r s y e t i m i

Paditësja me datë 14.12.2015 ka paraqitur padi kundër të paditurit, me të cilën ka kërkuar nga i padituri t'a rimbursojë shumën e cekur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, në emër të rimbursimit të dëmit të shkaktuar në aksidentin e trafikut të datës 26.11.2012, ku si shkaktar i aksidentit është i padituri, i cili në momentin e shkaktimit të aksidentit, ka qenë pa mbulesë siguruse, respektivisht me afat të skaduar të policës së sigurimit, ku nga ky aksident ka pësuar dëme në automjet i dëmtuar [REDACTED] nga Prishtina.

Mbi bazën e sigurimit të detyrueshëm nga autopërgjegjësia, për dëmet e shkaktuara palëve të treta nga përdorimi i mjeteve motorike, paditësja palës së tretë të dëmtuar i ka kompensuar dëmin material, që është shkaktuar si pasojë e këtij aksidenti, ndërsa ka paraqitur padi në gjykatë për rimbursimin e mjeteve nga i padituri, pasi që sipas paditëses, i padituri është fajtor sepse ka shkaktuar aksident duke vozitur pa mbulesë sigurimi të automjetit.



Gjykata, të paditurit, me datë 19.02.2016, i'a ka dorëzuar padinë së bashku me provat e lëndës si dhe aktvendimin për përgjigje në padinë e paditëses, por i padituri, ndonëse i ka pranuar shkresat me rregull (provë: fletëkthesa e nënshkruar me datë 08.03.2016) brenda afatit të caktuar ligor, nuk ka ushtruar në këtë gjykatë përgjigjen e tij nëse e kundërtshtron apo jo kërkesëpadinë e paditëses, ndërsa gjykata nga provat e çështjes, ka gjetur se themelësia e kërkesëpadisë del nga faktet e treguara në padi dhe se faktet e tilla nuk janë në kundërshtim me provat e propozuara nga paditësja.

Gjykata, me qëllim të vërtetimit të saktë të gjendjes faktike, ka bërë shqyrtimin e provave dhe shkresave tjera të lëndës, dhe atë: raportin e policisë nr.12-AR-2170 të datës 20.11.2012, nga i cili konstatohet se i padituri ishte shkaktar i aksidentit; Procesverbalin nr.2169/12 mbi dëmtimin e automjetit; Aktvlerësimin e dëmit nr.2169/12 të datës 12.12.2012; Vendimin BSK: FK-2169/2012 të datës 14.12.2012 për lartësinë e kompensimit; Ujdinë jashtëgjyqësore të datës 13.08.2014 në mes të paditëses dhe të dëmtuarit për lartësinë e shpërblimit të dëmit; raportin e pagesës së shumës prej 430 € të cilën paditësja ia ka paguar të dëmtuarit përmes transaksionit bankar të datës 18.08.2014.

Nga shqyrtimi paraprak dhe analizimi i provave del se dëmi ishte shkaktuar me fajin e të paditurit nga se në momentin e shkaktimit të aksidentit i padituri ishte duke vozitur pa mbulesë siguruese të automjetit. Po ashtu nga provat e dorëzuarra shihet se paditësja të dëmtuari ia ka kompensuar dëmin e shkaktuar nga i padituri në shumë prej 430 €, dhe nga e gjithë kjo del themelësia e kërkesëpadisë së paditëses.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi bazur në nenin 150 të LPK-së, lidhur me nenin 136 par.1 dhe nenit 170 të LMD-së si dhe nenit 14 të Ligjit nr.04/L-018 për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia.

#### GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

REPUBLIKA E KOSOVËS  REPUBLIKA KOSOVO

C.nr.847/13, me datën 09.01.2018

VENDIMI ËSHTË I PLOTFUQISHËM  
ODLUKA JE PRAVNOSENZA  
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD  
FERIZAJ II UROŠEVAC

Më 09.02.2018

**KËSHILLE JURIDIKE;** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh pas pranimit të tij, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.

